



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 16/10 Prot

Vlorë, më 24.10. 2022.

VENDIM

Nr. 12 , datë 14.10.2022

PËR

**MIRATIMIN E AUTORIZIMIT “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR” PËR
VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE, ME VENDNDODHJE: PLAZHI
DRIMADHËS, BASHKIA HIMARË, QARKU VLORË**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e autorizimit, “Për përdorim burimi ujor”, për veprimtari ndërtimore në brigje (në rastin kur përdorimi është për sip.e strukturës > 150 m² dhe > se 5 m hyrje në trupin ujor nga vija e bregut), me vendndodhje: Plazhi drimadhës, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë për subjektin “Bashkia Himarë”.

2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Deti Jon

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH).

X1 466889.691	Y1 4446672.933	Z1 - 0.8 m
X2 466884.535	Y2 4446678.388	Z2 - 1.0 m
X3 466888.692	Y3 4446739.833	Z3 - 2.0 m

X4 466912.768 Y4 4446722.334 Z4- 2.5 m

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: Ndërtimi i Molit Drimadhë (pjesë integrale lidhëse e projektit të shëtitorës bregdetare në Drimadhë).

3.Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.



K R Y E T A R

FLAMUR MAMAJ